

Së bashku për një kornizë negociuese për një proces të suksesshëm

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (CIG) mbledhi përsëri më 8-10 korrik 2022, në Solothurn të Zvicrës, tryezën e rumbullakët me zyrtarë të lartë të partive kryesore politike të Serbisë dhe Kosovës. Të pranishmit diskutuan çështjet dhe parimet për një kornizë më të mirë për negocimin e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Tryeza është pjesë e një projekti më të madh për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë i financuar dhe implemtuar në bashkëpunim me Departamentin Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës (FDFA). Raporti nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e pjesëmarrësve individualë, CIG, ose FDFA, por pasqyron diskutimin në tërësi. Pati konsensus midis pjesëmarrësve se është i nevojshëm një përparim në mosmarrëveshjen Serbi-Kosovë dhe se të gjitha palët duhet të kërkojnë një rrugë që çon drejt një zgjidhjeje.

Në seancën e parë, pjesëmarrësit u ndanë në tre grupe për të propozuar angazhimin e dëshiruar të BE-së dhe SHBA-së në procesin e dialogut dhe për të identifikuar incentivë për Kosovën dhe Serbinë që do të jepen nga BE-ja dhe SHBA-ja për të inkurajuar palët që të arrijnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse. Më poshtë është një kombinim i sugjerimeve nga të tre grupet.

Procesi

- BE-ja dhe SHBA-ja duhet të ndryshojnë rolin e tyre nga “lehtësues pasivë në udhëheqje dhe ndërmjetësim aktiv.”
- BE-ja dhe SHBA-ja duhet të hartojnë një udhërrëfyes të qartë dhe një kornizë kohore për dialogun.
- BE-ja dhe SHBA-ja duhet të qartësojnë gjendjen e lojës, të përcaktojnë një vizion dhe vlera të qarta, të kenë një qëndrim të përbashkët për dialogun dhe të bien dakord për një sërë parimesh.
- BE-ja, SHBA-ja, Kosova dhe Serbia duhet të pranojnë se mosmarrëveshjet politike, jo ato teknike, janë çështjet kryesore të mosmarrëveshjes.
- Në ndërkohë, marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të mund të bazoheshin në parimin e reciprocitetit.
- Dialogu i Brukselit dhe marrëveshja e Uashingtonit duhet të bashkohen.
- BE-ja duhet të krijojë një mekanizëm për zbatimin e marrëveshjeve.
- Palët duhet të vazhdojnë me zbatimin e marrëveshjeve të vjetra, si ndërtimi i gjashtë objekteve të kalimit kufitar, i parashikuar në marrëveshjen IBM, si dhe pajisja e tyre me staf përkatës, në mënyrë që të thjeshtohen procedurat dhe të shkurtohet koha e pritjes.

Incentivat

- BE-ja duhet t'i ofrojë Ballkanit Perëndimor anëtarësimin në BE si tërësi, jo secilit shtet veç e veç.
- BE-ja duhet më në fund t'i japë Kosovës liberalizimin e vizave.

- SHBA-ja dhe BE-ja duhet të lehtësojnë një “dialog për njohje” ndërmjet Kosovës dhe pesë vendeve të BE-së që nuk e njohin atë.
- BE-ja duhet të ofrojë statusin kandidat për Kosovën. NATO duhet ta konsiderojë anëtarësimin e Kosovës në programin e Partneritetit për Paqe si hapin e parë drejt anëtarësimin në NATO.
- BE-ja duhet të hapë klasterë të reja në negociatat për anëtarësim me Serbinë dhe t’i ofrojë një datë tentative për anëtarësim të plotë në BE.
- SHBA-ja dhe BE-ja duhet të hartojnë një pako investimi për Serbinë dhe Kosovën, përfshirë mbështetje financiare për projektet e përbashkëta në infrastrukturë dhe energji.
- BE-ja dhe SHBA-ja mund të mbështesin krijimin e një universiteti të përbashkët për Kosovën dhe Serbinë në të cilin studiojnë rreth 1,000 studentë nga secila palë.

Kompenzime për koncesionet

Pjesëmarrësit thanë se është koha për një zgjidhje dhe rekomanduan që BE dhe SHBA të kenë një qasje të përbashkët në përcaktimin e problemeve dhe zgjidhjeve. “Duhet ta zgjidhim këtë mosmarrëveshje dhe të mos ua kalojmë fëmijëve tanë.” Disa thanë se BE-ja nuk është e gatshme “të japë atë që mund të japë,” por kishin shpresë se ajo mund të bëhej më fleksibile në të ardhmen e afërt, madje edhe t’u ofrojë një rrugë më të shpejtë anëtarësimi në BE shteteve të Ballkanit Perëndimor, pasi ky i fundit po bëhet gjithnjë e më shumë një interes i rëndësishëm gjeopolitik. Shumë folës thanë se SHBA-ja gjithashtu nuk është e gatshme “të paguajë çmimin.” Një proces negociues eventual duhet të përfshijë edhe shkopinjtë edhe karrota, edhe pasojat për mosbashkëpunim. Si Serbia edhe Kosova duhet të dinë se cilat janë pasojat nëse njëri prej tyre e bllokon procesin.

Anëtarësimi i Serbisë në BE tashmë kushtëzohet nga Kapitulli 35, i cili kërkon një marrëveshje normalizimi me Kosovën. Një numër i folësve thanë se disa vende të Quintit po e kushtëzojnë mbështetjen e tyre për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës me progresin në dialog.

Kishte konsensus se dialogu i Brukselit është i dobët. “Në dy vjet nuk ka pasur asnjë fjalë të vetme për të ardhmen e kësaj marrëdhënie!” Dhe se palët duhet të ndërtojnë një proces më të mirë. Një folës, megjithatë, paralajmëroi se as procesi më i mirë nuk mund të kompensojë mungesën e vullnetit politik, gjë që duket të jetë rasti në Kosovë dhe Serbi. ‘Zotërimi’ i procesit është një tjetër element kyç në një proces negociues. Por dialogu i Brukselit ka forcuar besimin në Kosovë dhe Serbi se zgjidhjet vijnë nga jashtë. Kjo duhet ndryshuar. Një marrëveshje gjithëpërfshirëse kërkon një proces gjithëpërfshirës.

Palët në dialog duhet të gjejnë një “pako kompensimi” për Serbinë, pasi shumë njerëz në këtë shtet mendojnë se kanë “humbur diçka.” “Nëse nuk keni asgjë për të ofruar, mos na shtyni neve,” tha një pjesëmarrës nga Beogradi. Por çfarë mund të përfshijë një “pako kompensimi” për Serbinë? Disa folës thanë se Serbisë nuk i intereson nëse kompensimi vjen nga Kosova, BE-ja apo SHBA-ja. “Ajo thjesht ka nevojë për diçka në këmbim, nga vjen ajo diçka është më pak e rëndësishme.” Disa sugjeruan se pakoja mund të përfshijë një kombinim të incentivave nga BE-ja dhe SHBA-ja, si një paketë financiare dhe një rrugë më e shpejtë drejt BE-së, dhe disa nga Kosova, siç është formimi i Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Një folës shpjegoi se Serbia ndihet “e poshtëruar nga proceset e mëparshme dhe nuk mund të përballojë të ndëshkohet më tej,” duke shtuar se vendi ka nevojë për disa inventiva. “BE e di se Serbia nuk mund t’a njohë Kosovën pa kompensim, por më pas kancelarja gjermane Angela Merkel tha se ajo nuk mund të ofronte asgjë thelbësore dhe nuk e shtyu më tej Beogradin, dhe tani, kancelari i ri Olaf Scholz ka

një lloj tjetër mesazhi,” duke iu referuar kancelarit Scholz që sugjeroi se Serbia duhet t’u njohë Kosovën për t’iu bashkuar BE-së. Folësi përfundoi se nuk ka dyshim se Serbia duhet të kompensohet, por pyetja është nga kush? “Ne kemi nevojë për të na qartësuar këtë.” “Serbia nuk ka ndërmend ta zhbëjë pavarësinë e Kosovës, por ka nevojë për kompensim për një kompromis të tillë dhe nuk ka rëndësi se nga ku ose kush vjen ai.”

Një folës sugjeroi që objektivat e dialogut të zhvendosen më shumë drejt së ardhmes. “Punë si zakonisht nuk funksionon më.” Disa folës ranë dakord se Kosova dhe Serbia nuk duken serioze për një marrëveshje “por as BE dhe SHBA,” përfunduan disa. Një folës tjetër tha se BE-ja e filloi procesin pa një strategji: fillimisht përdori ‘paqartësitë konstruktive’ si parim, më pas ‘asgjë nuk është rënë dakord derisa të bihet dakord për gjithçka’ dhe tani “ne jemi kthyer në darka dhe takime për të diskutuar një agjendë.” As rritja e numrit të të dërguarve të posaçëm nuk duket të ketë ndonjë efekt. Por status quo-ja ekzistuese është gjithashtu pjesë e procesit. Shumë ranë dakord se elementët kryesorë të procesit janë qartësia, udhëheqja dhe koha.

Palët duhet të negociojnë, jo të diskutojnë dhe të mbyllin këtë kapitull. Serbia mund të ndjejë se ka humbur diçka, por duhet të kërkojë një formë kompensimi nga komuniteti ndërkombëtar, tha një folës. Kompromis do të thotë se secila palë duhet të ketë disa fitore të vogla. “Kosova thotë le t’i japë BE-ja diçka Serbisë në këmbim, por pastaj BE-ja thotë le t’i japë Kosova diçka në këmbim.” Një rezultat i mundshëm është “pak nga të dyja,” duke sugjeruar integrimin nga BE-ja dhe Asociacioni/Komuniteti nga Kosova. Një folës tha se Serbia tashmë ka pasur disa fitore, si “shumica e dyfishtë në parlamentin e Kosovës, krijimi i komunave të reja me shumicë serbe në Kosovë dhe disa kompetenca shtesë për komunat me shumicë serbe.” Një folës vuri në dukje se një fitore për serbët e Kosovës do të ishte “zbatimi i plotë i Planit të Ahtisaarit.” Dhe fitoret e vogla ose “ruajtja e fytyrës” është diçka për të cilën duhet të mendojnë ndërmjetësit.

Shkëmbimi i territoreve është një ide e vdekur, status quo-ja nuk është e qëndrueshme dhe normalizimi pa njohje nuk është i mundur, argumentoi një folës. Ai shtoi se “serbët dhe shqiptarët e njohin njëri-tjetrin mjaft mirë, por duhet të ndryshojnë mënyrën se si e shohin njëri-tjetrin.” As mediat nuk po ndihmojnë shumë në këtë drejtim, me theksimin dhe fryrjen e ankesave etnike në vend që të aplikojnë një qasje më pajtuese. “Kosova dhe Serbia po konkurrojnë se kush po e dëmton më shumë njëra-tjetrën në vend që të zgjidhin problemet e tyre.” Integrimi në BE është një aspiratë e përbashkët dhe mund të shërbejë si “garancë” për një marrëveshje. Folësi tha se është koha të vendosim të gjitha letrat në tryezë.”

Parimet dhe problemet

Në fillim të diskutimeve, një pjesëmarrës theksoi se të dyja palët duhet të kuptojnë dhe pranojnë dy aksioma kyçe – pavarësia e Kosovës nuk po shkon askund dhe as serbët në Kosovë nuk po shkojnë askund dhe do të mbeten gjithmonë pjesë e Kosovës. Hapësira për negociata është mjaft e ngushtë, kryesisht për shkak se nuk ka ide të reja. Dialogu ka vazhduar paralelisht me procesin e pajtimit, ku pjesë e dialogut janë edhe disa çështje si personat e pagjetur. Dialogu duhet të ketë një agjendë dhe një listë çështjesh për negociata. Faza e mëparshme e procesit kishte tetë pika në rendin e ditës. Dialogu aktual nuk ka një agjendë të re dhe më së shumti është i angazhuar në zbatimin e disa marrëveshjeve të vjetra dhe trajtimin e “krizave” të reja, gjë që është “e mirë, por jo e mjaftueshme.”

Një folës tha se zërat ndërkombëtarë për “njohje reciproke” po rriten, por një folës tjetër u përgjigj se “njohja reciproke” nuk është një kompromis. “Është një lojë baraz me zero.” Folësi tha se këmbëngulja për njohje pa një proces negociues është një recetë dështimi. Për t’i dhënë besueshmëri dialogut, BE-ja dhe SHBA-ja në koordinim me Serbinë dhe Kosovën duhet të krijojnë një mekanizëm mbikëqyrës të zbatimit.

Një proces i fortë do të kërkonte një agjendë të fortë. Një folës sugjeroi të ashtuquajturin model gjermano-gjerman si zgjidhje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ku palët “e njohin njëra-tjetrën në gjithçka, përveç njohjes formale.” Ky model do të përfshinte edhe formimin e Asociacionit/Bashkësisë. Mund të hulumtohen edhe opsione të tjera, por pa “njohje formale,” tha folësi. Një marrëveshje e mirë do të siguronte parashikueshmëri dhe siguri. Ideja e shkëmbimit të tokës u përmend kalimthi nga disa folës, por nuk gjeti mbështetje thelbësore nga grupi. “Shkëmbimi i tokës nuk është një opsion tani pas luftës në Ukrainë.” Një folës shtoi se një model eventual duhet të kënaqë si lidhshimin politik ashtu edhe qytetarët. Mungesa e mençurisë politike shihet si pengesa kryesore për progress. Por zgjidhja nuk duhet të rrezikojë stabilitetin në Serbi, Kosovë, apo rajon.

Kosova dhe Serbia kanë një sërë synimesh të përbashkëta: një marrëveshje gjithëpërfshirëse, integrim në BE dhe pajtimin. Pjesëmarrësit sugjeruan disa iniciativa për avancimin e këtyre synimeve, duke përfshirë bashkëpunimin akademik, ndërveprimet kulturore, zhvillimin ekonomik. Një folës tha se pajtimi është një proces i ndërlikuar dhe mund të vijë vetëm pasi konflikti të përfundojë përmes një marrëveshjeje. “Numri i njerëzve kundër pajtimit është më i madh se numri i njerëzve në favor të pajtimit,” tha folësi, duke shtuar se problemi me pajtimin është se është e vështirë për lidhshimet politike të marrin përgjegjësi për veprimet e lidhshimit të shtetit të tyre.

Siç theksoi një pjesëmarrës, status quo-ja jo vetëm që është e papranueshme, por ajo duhet të ndryshohet shpejt pasi Serbia dhe Kosova po përballen me një botë që po ndryshon shpejt e të mbushur me emergjencë të reja. “Ne ose mund të dëmtojmë njëri-tjetrin ose mund ta mbështesim njëri-tjetrin. Mbështetja duket se është qasja e duhur.” Vetëm duke i dhënë fund këtij konflikti Kosova dhe Serbia mund të merren me botën e re në zhvillim në mënyrë më efektive dhe më të suksesshme.

Pjesëmarrësit

Sipas rendit alfabetik anglisht

Natan Albahari, Lëvizja e Qytetarëve të Lirë
Gresa Baftiu, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Gordana Comic, Qeveria e Serbisë
Shpetim Gashi, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Ardian Gjini, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Lutfi Haziri, Lidhja Demokratike e Kosovës
Ramadan Ilazi, Analist
Dalibor Jevtic, Lista Serbe
Mimoza Kusari, Lëvizja Vetëvendosje/Alternativa
Bernard Nikaj, Partika Demokratike e Kosovës
Branko Ruzic, Partia Socialiste e Serbisë
Alex Roinishvili Grigorev, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Roland Salvisberg, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës
Nemanja Starovic, Partia Progresive Serbe
Ana Stevanovic, Partia për Liri dhe Drejtësi
Xhelal Svecla, Lëvizja Vetëvendosje
Dobrica Veselinovic, Koalicioni Mos e leni Beogradin të fundoset/Ne duhet